



**Prishtinë: 30.09.2011**

**Kodi i ZRRE-së: V\_377\_2011**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_599\_06\_11**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_599\_06\_11**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 17.06.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:**

### **VENDIM**

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Hazir Terpeza nga Prishtina (shifra e konsumatorit DPR - 205641) bazuar në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 22.09.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 13.09.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 02.03.2010 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për ndërrim njehsori.  
**Provë:** Aplikacioni për ndërrim njehsori, i datës 02.03.2010
- Me datë 16.04.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë regjistruar të dhënat teknike të njehsorit elektrik nr. 9183064 të vendosur nga vetë konsumatori si dhe kanë evidentuar se konsumatori nuk prezanton njehsorin e vjetër elektrik nr. 17660122.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit nr. 007720 i datës 16.04.2010
- Me datë 27.05.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe pajisjeve që posedon konsumatori.  
**Provë:** Procesverbalin e KEK-ut nr. 0374868 të datës 27.05.2010
- Me datë 23.08.2010 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR10HP08591 në vlerë prej 270.88 €.   
**Provë:** Fatura DPR10HP08591 e datës 23.08.2010
- Me datë 02.09.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 13.09.2010 Departamenti për Konsumatorë në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 13.09.2010



- Me datë 22.09.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 07.06.2011 DMK ka lëshuar një vendim duke refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të:
  1. Shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR10HP08591 të datës 23.08.2010 në vlerën 270.88 €.
  2. Rikalkulojë faturën e rikthimit të humbjeve për periudhën gjashtë mujore duke marrë për bazë shpenzimin mujor prej 519.83 kWh/muaj.
- Me datë 17.06.2011 konsumatori ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_599\_06\_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK\_V\_599\_06\_11** të mbetet në fuqi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar